



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,  
Ref:15.10.2017\575-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Portalit të lajmeve Lajmi.net**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Arbër Hadrit kundër portalit të lajmeve Lajmi.net lidhur me artikullin "I dyshuari për vrasjen e Aulon Zekës është djali i Arbër Hadrit, ish drejtorit të muzeut të Kosovës" dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet

## A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se është identifikimi nëpërmjet të këtij shkrimi i identitetit të të miturit. Gjithashtu, në ankesë thuhet se është prezentuar në formë joprofesionale dhe joetike fotoja e babait të të miturit të dyshuar për vrasje.

Në fund të ankesës, gjithashtu thuhet se është shkelur edhe e drejta për prononcim të Kodit të Mediave të Shkruara.

Bordi i KMSHK, pasi shqyrtoi artikullin dhe ankesën, njëzëri shprehu keqardhjen e thellë për këtë rast tragjik, ku viktimë është një i mitur i cili dyshohet se është vrarë me armë zjarri nga një i mitur tjetër, i cili tani është në paraburgim.

KMSHK, shqyrton rastet nga aspekti etik i shkrimeve në media, andaj gjeti se në këtë rast, Gazeta Express ka shkelur Kreun VI, pika 2, i cili thotë: "gazetat, portalet dhe agjencitë e lajmeve në asnjë mënyrë nuk do të identifikojnë fëmijët nën moshën 18 vjeçare të cilët janë të përzier në vepra penale, qoftë si dëshmitar apo të pandehur".

Në rastin konkret nëpërmjet publikimit të fotos dhe emrit së babait i të dyshuarit për vrasje është shkelur ky parim, i cili kërkon që mosidentifikimi i fëmijëve duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurës ligjore, si dhe asnjë informacion që shpie në identifikimin e të miturit nuk bën të publikohet. Në këtë rast, të dhënat janë botuar vetëm me iniciale, por publikimi i emrit dhe fotos të babait e identifikon në mënyrë të tërthortë edhe të miturin e dyshuar.

KMSHK gjeti se është shkelur edhe Kreu V (personat e akuzuar për vepra penale) dhe Kreu VII (privatësia) i Kodit të Mediave të Shkruara se trajtimi ndaj individëve të prekur nga tragjedia duhet të bëhet në mënyrë të diskrecionit të plotë. Këto parime fitojnë veçmas në peshë

kur bëhet fjalë për shkrime ku të miturit ndodhen si kryes apo dëshmitarë të ndonjë tragjedie.

KMShK nuk miratoi pikën e ankesës lidhur me Kreun IV (e drejta për t'u përgjigjur) të Kodit të Mediave të Shkruara, pasi kjo nuk ka pasur nevojë për ndonjë sqarim të veçantë nga palët, dhe rasti është në procedurë gjyqësore dhe bëhet fjalë për një të mitur.

Vendimi u mor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**